



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 115, Datë 14.05.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “UDHËZUESIT PËR
KËRKESAT ORGANIZATIVE, ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË LIDHJE ME
SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE” (KORP)**

Në mbështetje të neneve 16; 7; 56 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike“, ndryshuar; nenit 40 pika 6 të Rregullores së Komisionit të BE 2017/1485, “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (SO GL)”; nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 14.05.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Udhëzuesit për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP),

Konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a, është anëtar me të drejta të plota i Rrjetit evropian të operatorëve të sistemit të transmetimit për energjinë (ENTSO-E);
- OST sh.a me shkresën nr. 3103 Prot., datë 27.04.2018, ka përcjellë në ERE për miratim propozimin e të gjithë OST-ve mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP);
- Ky propozim vjen në zbatim të neneve 7; 56 dhe 63 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 117, pika 5 të Kodit të Transmetimit të miratuar me vendimin e ERE nr. 186, datë 10.11.2017, sipas të cilit “OST do të zbatojë Urdhërin e ENTSO-E (European Network of Transmission System Operators for Electricity/ Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike), të miratuar nga të gjithë OST-të e zonës sinkrone, në lidhje me kërkesat kryesore, organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).
- Interpretimi i KORP do të bëhet në përputhje me Kodin e Transmetimit si dhe dokumentat e tjerë të cilëve iu referohet dokumenti. KORP është propozim i të gjitha OST-vë të ENTSO-E për kërkesat themelore organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave, draftuar në përputhje me nenin 40 pika 6 të

Rregullores së Komisionit të BE 2017/1485 “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike SO GL” (*Security of Operation Guideline, or Commission Regulation (EU) 2017/1485 of 2 August 2017 establishing a guideline on electricity transmission system operation / Rregullorja e Komisionit të (BE) 2017/1485, ose Udhëzuesi mbi Sigurinë Operacionale*).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Udhëzuesit për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave (KORP).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI